

VENDIM
Nr.125, datë 14.3.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.75, DATË 6.2.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E PAGESAVE, QË KRYHEN NË ENTIN RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pagesat që kryhen në Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, të miratuara me vendimin nr.75, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGESAT QË KRYHEN PRANË ERT-SË

Në listën e pagesave që kryhen pranë ERT-së, pika III, pagesa vjetore të licencës, shtohet:

A)

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Operatori publik i telekomunikacioneve		
Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm për zonat urbane (bashki)	100 000 lekë/bashki	Çdo vit

B)

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Licencë e përgjithshme		
Ofruesi i shërbimit të telekomunikacioneve	200 000 lekë	Çdo vit